



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 494 prot.

Vlorë, më 26.04 2023

PROJEKT VENDIM
Nr. ____ , Datë ____ . ____ .2023

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.1, DT.18.01.2023
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2023 I NDRYSHUAR ”**

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 31.03.2023 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlorë, si dhe në diskutimet dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit, mbështetur në; Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 19.01.2023 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, V.K.B nr.1 datë 18.01.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2023”.

VENDOSI:

1. Në fondet e parashikuara në Buxhetin e Bashkisë me kod programi K0110 të pakësohet fondi prej 6,048 mijë lekë në llogarinë ekonomike 231 investime rikonstruksion i disa akseve në Njësinë Administrative Novoselë dhe të shtohet në llogarinë ekonomike 231 strukturë me pilota në sistemimin e skarpatit pas godinës së Bashkisë në shumën 6,048 mijë lekë.

- a) Shtohet strukturë me pilota në sistemimin e skarpatit pas godinës së Bashkisë

Gr	Fit	Kap	600	601	602	231	
0		1				6,048,000	Investim rikonstruksion i disa akseve ne Njesine Administrative Novosele

- b) Pakësohet rikonstruksion i disa akseve në Njësinë Administrative Novoselë.

Gr	Fit	Kap	600	601	602	231	
0		1				6,048,000	Strukture me pilota ne sistemimin e skarpatit pas godine se Bashkise

2. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dritan LELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 4941 prot.

Vlorë, më 26.04 2023

RELACION

“Mbi Projekt Vendimin për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.1, Dt.18.01.2023 për buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2023 I ndryshuar.”

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt Vendimi që po ju paraqesim lidhet me një ndryshim në zërin investime të planifikuara në buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2023.

Në buxhetin e Bashkisë Vlorë të vitit 2022 ishte parashikuar fondi prej 10,500 mijë lekë për strukturën me pilota në funksion të sistemit të skarpatit pas godinës së Bashkisë në kuadër të projekti të sallës së Këshillit të Bashkisë. Një pjesë e punimeve u realizua gjatë vitit 2022 dhe bazuar në situacionin pjesor u shlye detyrimi përkatës gjatë atij viti. Ndërkohë diferenca e situacionit përfundimtar prej 6,048 mijë lekë nuk u parashikua në buxhetin e Bashkisë për vitin 2023 pasi nuk u paraqit në kohë për tu pasqyruar si detyrim i prapambetur. Duke qenë se procedura e realizimit të projektit rikonstruksion i disa akseve në Njësinë Administrative Novoselë nuk ka filluar propozojmë që pa ndryshuar totalin e fondit të investimeve të pakësohet kjo shumë nga fondi i planifikuar për projektin rikonstruksion i disa akseve në Njësinë Administrative Novoselë I cili është parashikuar në shumën 46,425 mijë lekë. Kjo pasi aktualisht punimet në projektin e skarpatit pas godinës së Bashkisë ka përfunduar si dhe është realizuar procedura paraprake e marrjes në dorëzim të punimeve dhe është parqitur situacioni përfundimtar nga subjekti zbatues.

Nga sa më lartë kërkojmë nga ana juaj të miratohet ky projekt vendim për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve ndaj subjektit të kontraktuar si dhe të evitohet sanksionet ligjore që rrjedhin nga moshlyerja në kohë e këtyre detyrimeve.

KRYETARI

Dritan LËLI

